

URDHËR
Nr. 6, datë 7.1.2021

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE
AKSESIN NË ARKIVIN ELEKTRONIK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Krijimi, administrimi dhe aksesimi në arkivin qendror elektronik të dokumenteve noteriale për të gjithë noterët, për periudhën përpara fillimit të funksionimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë, kryhet sipas rregullave të këtij urdhri.

2. Arkivi qendror elektronik mban në ruajtje, në format elektronik, të gjithë veprimtarinë noteriale të krijuar nga noteri që nga momenti i fillimit të ushtrimit të këtij profesioni, duke përfshirë të dhënat për aktet dhe veprimet noteriale, për testamentet, për dëshmitë e trashëgimisë, dokumentet e skanuara të akteve dhe të veprimeve noteriale, të dhënat për palët, individët dhe subjektet.

3. Arkivi qendror elektronik i dokumenteve për të gjithë noterët, i krijuar për periudhën përpara fillimit të funksionimit të sistemit elektronik të Dhomës, integrohet dhe bëhet pjesë përbërëse e sistemit elektronik të Dhomës.

4. Arkivi qendror elektronik do të vazhdojë në mënyrë kronologjike me aktet noteriale të krijuara dhe të regjistruara në sistemin elektronik të Dhomës që nga data e bërjes funksionale të këtij të fundit.

5. Në çdo rast, të dhënat e regjistruara në sistemin elektronik të Dhomës, sipas këtij urdhri, dërgohen për regjistrim, në kohë reale, në sistemin elektronik të Regjistrimit Noterial Shqiptar, sipas rregullave të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për mënyrën e ndërlikohjes, nivelin e aksesit dhe bashkëveprimin të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave.

6. Arkivi qendror elektronik bëhet i disponueshëm vetëm pasi të standardizohet dhe të jetë certifikuar elektronikisht.

7. Arkivi qendror elektronik duhet të garantojë elementet e mëposhtme:

a) menaxhimin në mënyrë uniforme dhe me efektivitet të akteve dhe të veprimeve noteriale elektronike;

b) saktësinë dhe leximin e të dhënave që regjistrohen në të;

c) aksesimin e dokumentacionit noterial sa herë që lind nevoja nga personat e autorizuar;

ç) mbrojtjen e dokumentacionit noterial nga aksesimi i paautorizuar.

8. Aksesimi i subjekteve në arkivin qendror elektronik është, si më poshtë vijon:

a) institucioni administrues i arkivit qendror elektronik është Dhoma Kombëtare e Noterisë;

b) subjekte të interesuara janë Ministria e Drejtësisë dhe noterët.

9. Dhoma Kombëtare e Noterisë ka të drejta të plota administrative mbi arkivin qendror elektronik në rolet e administratorit, raportuesit, audituesit dhe zhvilluesit.

10. Ministrisë së Drejtësisë i jepet aksesimi i nevojshëm në arkivin qendror elektronik, në rolet audituese, për të garantuar mbikëqyrjen e administrimit dhe të përdorimit të këtij arkivi, si dhe prodhimin e statistikave përkatëse.

11. Noterët, si përdorues të arkivit qendror elektronik, kanë të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet noteriale të regjistruara nga zyra e tyre noteriale.

12. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

13. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË

Etilda Gjonaj (Saliu)